



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 5994 /2026

Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për
Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Korrik, 2026

1. Hyrje

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajit maj të këtij vitit, ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Qeveritare (KASH) për periudhën 2027 – 2029.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH 2027-2029) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2027, i cili do të miratohet nga Asambleja Komunale. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë, e cila reflekton mjedisin makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Pas hartimit nga Ministria e Financave të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2027 – 2029), pason edhe Qarkorja Buxhetore për gjitha Organizatat Buxhetore mbi bazën e së cilës të gjitha OB-të njoftohen mbi instruksionet e hartimit të buxheteve të tyre për periudhën 2027 – 2029. Qarkorja Buxhetore 2027/01 ofron udhëzimet e para të përgatitjes së buxhetit komunal, përfshirë këtu kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestarë të financimit për komunat për periudhën 2027 – 2029. Bazuar në kufijtë fillestarë të përcaktuara nga Qarkorja Buxhetore 2027/01, Autoritetet Komunale janë angazhuar në përgatitjen e KAB-it 2027-2029 të Organizatës Buxhetore - 659 Komuna Hani i Elezit.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale - KABK, siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KABK siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

KAB-i Komunal, është dokumenti i parë që i prinë procesit të hartimit të Buxhetit pas pranimi të Qarkores së parë Buxhetore që lansohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për çdo vit.

Kalendarin kohor të procesit buxhetorë sipas udhëzimeve të Qarkores Buxhetore 2027/01 po e paraqesim si vijon:

Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendar kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

1. **30 Qershor:** Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029,
2. **30 Shtator:** Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitet 2027-2029 nga Kuvendi Komunal,

3. **30 Shtator:** pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dokumentet si në vijim:
- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
 - Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2027- 2029, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
 - Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
 - ✓ Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2027-2029 (kopje e shtypur prej SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - ✓ Tabela 4.1.B - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve përmes klauzolës së investimeve dhe huamarrjes,
 - ✓ Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2027 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2028-2029 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - ✓ Tabela 4.2.B - financimi i projekteve kapitale përmes klauzolës së investimeve dhe huamarrjes,
 - ✓ Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - ✓ Tabelat e Buxhetimit sipas performancë,
 - ✓ Buxhetimi gjinor.

Më në detaje kemi paraqitur më poshtë fazat e procesit buxhetor komunal 2027:

1. Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029:

- Dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike.

2. Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale:

- Kryetari i Komunës, Drejtori i Financave dhe drejtorët e drejtorive komunale bëjnë shqyrtimin e politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre sektoriale.

3. Kufijtë fillestarë specifik për programet buxhetore:

- Rekomandohet se kufijtë fillestarë specifik të programeve duhet të përcaktohen para datës 01 Korrik 2026 bazuar në projeksionet e vendosura te Qarkores 2027/01 nga MFPT.

4. Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve:

- Drejtorët e drejtorive bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve, përfshirë politikat e reja si dhe opsionet për kursime të mundshme.

5. Dëgjimet buxhetore:

- Seanca dëgjimore në secilën drejtori komunale me qëllim të shqyrtimit të buxheteve të propozuara si dhe dëgjime publike të hapura me publikun.

6. Shqyrtimi i buxhetit komunal nga Kuvendi Komunal:

- Kryetari i Komunës përmes drejtorisë së Financave dorëzon propozim-buxhetin në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe aprovim, jo më vonë se 01 Shtator 2026.
- 7. Arovimi i buxhetit te propozuar nga Kuvendi Komunal dhe dorezimi në MFPT:**
- Propozim buxheti komunal për vitin 2027 i aprovuar nga Kuvendi Komunal dorëzohet në MFPT deri më 30 Shtator 2026.

2. KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2027– 2029

Me Qarkoren Buxhetore 2027/01 janë përcaktuar Grantet Qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027 dhe orientimet për vitet 2028-2029, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, Qarkorja përcakton edhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2027 si dhe parashikimin afatmesëm 2028-2029. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumë vjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve. Projektet kapitale shumë vjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

Për vitin fiskal 2027 parashikohet një buxhet në lartësi prej 4,654,793.00 € apo një rritje prej 420,111.00 € apo për 9.92 % në raport me vitin 2026, kurse për vitin 2028 kemi një parashikim të buxhetit në lartësi prej 4,879,451.00 € apo një rritje prej 224,658.00 € ose 4.8 % në raport me vitin 2027, si dhe për vitin 2029 vlerësohet një buxhet prej 5,133,847.00 € apo një rritje prej 254,396.00 € apo për 5.2 % më i madh në raport me vitin 2028.

Analizuar financimin sipas llojeve të Granteve Qeveritare, në periudhën vijuese 2027-2029, financimi nga **Granti i përgjithshëm (GP)**, për vitin buxhetor 2027, do të kemi në dispozicion shumë prej 2,038,083.00 € apo një rritje prej 165,904.00 € apo 8.86 % në krahasim me vitin 2026. Te **Granti Specifik i Arsimit**, në vitin 2027 parashikohet të jetë në shumë prej 1,469,055.00 € ose një rritje prej 39,409.00 € ose 2.76 % në krahasim me vitin 2026.

Te **Granti Specifik i Shëndetësisë**, i cili financim qeveritar është në shumë prej 653,150.00 € për vitin 2027, ku kemi një rritje në krahasim me vitin 2026 për 77,013.00 € apo 13.3%.

Te **të hyrat vetanake komunale (THVK)** për vitin 2027, parashikohet të jenë në lartësi prej 494,505.00 € apo një rritje prej 137,785.00 € apo 38.6 % në krahasim me vitin 2026, ndërsa për vitin 2028 THVK parashikohen të jenë në lartësi prej 510,738.00 € apo një rritje prej 16,233.00 € apo prej 3.2 % krahasuar me vitin 2027, ndërsa për vitin 2029 kemi një vlerësim prej 537,073.00 € apo një rritje prej 26,335.00 € apo prej 5.1 % në krahasim me vitin 2028.

3. Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029

Fillimisht, nga Kryetari i Komunës u themelua grupi punues për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029 si dhe grupi punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Në planin e dëgjimeve buxhetore është specifikuar çdo detaj, duke filluar nga:

1. Aktivitetet para-përgatitore,
2. Aktivitetet Kryesore,
3. Masat që duhet të ndërmerren,
4. Staf i përgjegjës dhe stafi përkrahës/suportues,
5. Korniza kohore (Vendi dhe koha) dhe
6. Veprimet e ndërmarra.

<https://hannielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Plani-i-degjimeve-buxhetore-per-KAB-2027-2029.pdf>

- Orari/kalendari i dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029:

https://hannielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Njoftim-mbi-orarin-e-degjimeve-Buxhetore-KAB-2027-2029_page-0001.pdf

- Njoftimet e dëgjimeve, (te ky link nëpër faqe të ndryshme janë njoftimet e dëgjimeve):

https://haniielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Njoftim-mbi-orarin-e-degjimeve-Buxhetore-KAB-2027-2029_page-0001.pdf

- Te ky link janë të publikuara fotografitë e dëgjimeve buxhetore të mbajtura:

<https://haniielezit.rks-gov.net/news/nen-organizimin-e-kryesuesit-te-kuvendit-komunal-z-florim-shkreta-u-mbajt-degjimi-buxhetor-lidhur-me-kornizen-afatmesme-buxhetore-kab-2027-2029/>

4. Paraqitja tabelare e Kapitullit I

Përmbajtja	Përshkrimi	Shtesë / Link
Formimi i Grupit Punues	Data e formimit të grupit që ka planifikuar dhe organizuar konsultimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore.	(Të përfshihet data specifike në dokumentin përfundimtar)
Përgatitja e Planit dhe Kalendarit të Konsultimeve	Data: 04.08.2025	 https://haniielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Plani-i-degjimeve-buxhetore-per-KAB-2027-2029.pdf
Njoftimet për Konsultimet Publike	18.05.2026	https://haniielezit.rks-gov.net/news/rikujtimin-per-pjesemarrje-per-degjimet-buxhetore/
Procesverbalet e Konsultimeve	24.06.2026	 https://haniielezit.rks-gov.net/korniza-afatmesme-buxhetore-kab/?tax=
Konsultimet me Mekanizmat Lokalë	Janë njoftuar Kryetarët e Këshillave Lokal, paraprakisht të mbajnë takime me banorët e lokaliteteve dhe të diskutojnë rreth kërkesave, nevojave dhe prioritetëve të tyre. Gjatë dëgjimeve buxhetore Kryetarët e Këshillave Lokal kanë	Çdo administrator apo Kryetar i Këshillave Lokal ka përgatitur listën e projekteve të cilat janë më me prioritet për Lokalitetin e tyre.

	dhënë propozimet e banorëve nga takimet paraprake. Megjithatë, pjesëmarrësit përsëri kanë pasur mundësi të japin rekomandime dhe propozime tjera.	Në aneksin e mëposhtëm janë të adresuara kërkesat e tyre si dhe statusi i kërkesave me sqarimet e nevojshme.
Konsultimet nga Kryetari i Komunës	Janë mbajtur 3 dëgjime buxhetore të organizuara nga Kryetari i Komunës me grupe të ndryshme të interesit dhe nëpër lokalitete të ndryshme. Është bërë një gjithpërfshirje e qytetarëve/eve.	Në aneksin e mëposhtëm janë të adresuara kërkesat e tyre si dhe statusi i kërkesave me sqarimet e nevojshme.
Konsultimet e pranuar me shkrim	Gjatë periudhës së mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029 nuk kemi pranuar asnjë kërkesë fizike apo përmes postës elektronike.	-

PËRMBLEDHJE TABELARE E KONSULTIMEVE TË MBAJTURA

Grupi i interesit / Me kë është mbajtur dëgjimi	Data dhe ora	Lokacioni	Nr. total i pjesëmar rësve	Gra	Burra	Persona me aftësi të kufizuar	Nr. total i kërkesav e ¹	Investime Kapitale	Subvenci one	Mallra dhe Shërbime	Kërkesa për informacion / pyetje
Dëgjim Buxhetor i hapur për të gjithë qytetarët/et	02.06.2026 10:30	Salla Takimeve, Objekti i Komonës	20	11	9	/	2	1	/	-	1
Dëgjim Buxhetor me banorët/et e fshatit Paldenicë	02.06.2026 13:30	SHFMU "Kështjella e Diturisë"	13	6	7	/	3	3	/	/	1
Dëgjim Buxhetor me banorët/et e fshatit Gorancë	02.06.2026 14:30	SHFMU "Veli Ballazhi"	14	3	11	0	14	10	1	3	-

5. METODOLOGJIA DHE KRITERET PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT TË KËRKESAVE

Duke u bazuar në të gjithë kërkesat e pranuar nga pjesëmarrësit nëpër dëgjime buxhetore si dhe kërkesat në forma të tjera, adresimin e tyre e kemi klasifikuar në:

1. **Pranim/Aprovim:** nënkupton që kërkesa konkrete e qytetarit/es konsiderohet se është e nevojshme për tu realizuar dhe si e tillë do të jetë pjesë e KAB 2027-2029. Pra kërkesat e tilla, si për projekte kapitale, subvencione apo mallra & shërbime janë pjesë e KAB 2027-2029 të miratuar në Kuvend Komunal.
2. **Adresim:** nënkupton që kërkesa e qytetarit/es adresohet te Subjekti, palët, Institucioni relevant. Kjo mund të jetë relevante psh kur kërkesat e qytetarëve nuk janë në kompetencën komunale dhe janë përgjegjësi/kompetencë e një insititucioni tjetër (si psh KEDS-it, Bifurkacionit, nivelit Qendror gjegjësisht Ministrinë e Linjës) dhe kur klasifikohet si e “Adresuar” nënkupton që Komuna do të adresoj apo ka adresuar kërkesën tek institucioni relevant.
3. **Pjesërisht e pranuar/aprovuar:** Këtu janë klasifikuar kërkesat e qytetarëve/eve të cilat mund të përfshijnë disa lloj intervenimesh (psh. Në kuadër të një propozimi ka disa kërkesa, prej të cilave disa mund të realizohen ndërsa të tjerat për arsye të ndryshme nuk do të realizohen). Në këto raste, Grupi Punues ka priorizuar segmente të kërkesës dhe si të tilla janë miratuar në Kuvend Komunal. Në këta raste, kërkesa mbetet pjesërisht e pranuar/aprovuar.
4. **E refuzuar:** Nënkupton kërkesat e qytetarëve/eve të cilat nuk përfshihen në KAB 2027-2029. Kjo mund të jetë për shumë arsye siç janë: mungesën e mjeteve financiare, fakti që kërkesa nuk bënë pjesë në prioritetet komunale, fakti që kërkesa është më shumë e natyrës individuale se sa me ndikim në komunitet, fakti që për realizimin e kërkesës/investimit do të duhet fillimisht të mënjanohen probleme të ndryshme si shpronësimet apo fakti që menaxhimi i pronës nuk është në kompetencë komunale, etj.

5. TABELARI I DETAJUAR SIPAS KATEGORIVE TË KËRKESAVE DHE STATUSIT QË MARRIN

INVESTIME KAPITALE			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultime	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
1. Rregullimi i këndit të lodrave në shkollën e fshatit Paldenicë	Betime Dernjani	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale në kuadër të KAB 2027-2029
2. Asfaltimi i rrugës në fshatin Vërtomicë	Ahmet Krasniqi	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale në kuadër të KAB 2027-2029.
3. Rregullimi i varrezave në fshatin Vërtomicë	Ahmet Krasniqi	Refuzuar	Ky projekt nuk ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale në kuadër të KAB 2027-2029.
4. Rregullimi i prockave	Ahmet Krasniqi	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale në kuadër të KAB 2027-2029.
5. Hapja e rrugës bypass Hani i Elezit - Gllaboçicë	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale në kuadër të KAB 2027-2029.
6. Asfaltimi i rrugës për te pllakata e dëshmorëve Feriz dhe Xhevdet Guri duke filluar nga varrezat , përroi, Sudonec dhe të vazhdohet nga “Molla e Osmanit” deri te përroi.	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Implementimi i këtij propozimi ka kosto shumë të madhe. Do të shqyrtohet dhe adresohet kjo kërkesë për t’u realizuar me Bashkëfinancim me Ministri të Linjës apo me Donatorë.
7. Shtrimi i kubëzave brenda varrezave të fshatit Gorancë.	Këshilli i fshatit Gorancë	Refuzuar	Ky projekt nuk ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale në kuadër të KAB 2027-2029.
8. Kapakët e shakteve prej varrezave, nëpër fshat dhe kanalizimi deri tek fshati Rezhancë.	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale në kuadër të KAB 2027-2029.

9. Rregullimi i asfaltit dhe vendosja e pengesave të shtrira nëpër fshat	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
10. Rregullimi i shëtitores Gorancë-Pisha-Hunel (kubëza, ndriçim, karrige, shtegu për biçiklistë)	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
11. Afaltimi i rrugës Hunel-Te Pishat	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
12. Shtrimi i asfaltit nga Lagja Huneli deri tek Pishat	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2027 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
13. Rregullimi i rrugës dhe pishinës publike te Gjura	Këshilli i fshatit Gorancë	Refuzuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim por kjo kërkesë nuk bën pjesë në prioritetet e vitit 2027 për shkak të mundësive të limituara buxhetore.
14. Rehabilitimi i rrugës kah Vorbat	Këshilli i fshatit Seçishtë	Aprovuar	Implementimi i këtij propozimi ka kosto shumë të madhe. Do të shqyrtohet dhe adresohet kjo kërkesë për t'u realizuar me Bashkëfinancim me Ministri të Linjës apo me Donatorë.
15. Rivitalizimi i kronit në mes të fshatit	Këshilli i fshatit Seçishtë	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2027 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
16. Të vazhdohet faza e dytë e kanalit të Llokës në Seçishtë në drejtim të arave.	Këshilli i fshatit Seçishtë	Refuzuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim por kjo kërkesë nuk bën pjesë në prioritetet e vitit 2027 për shkak të mundësive të limituara buxhetore.

SUBVENCIONE

Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Kërkesë nga Këshilli i fshatit Gorancë për ndihmë me të holla	Këshilli i fshatit Gorancë	Adresuar	Do të shqyrtohen mundësitë ligjore dhe buxhetore për realizimin e kësaj kërkesë.

MALLRA & SHËRBIME

Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
---	-----------------------------	--------------------	--

Lidhja e tensionit të lartë të rrymës që shkon në fabrikë për tek pompa e ujit në Sudonec si dhe shpenzimet e pompës ti barten komunës	Këshilli i fshatit Gorancë	Adresuar	Do të shqyrtohet realizimi i kësaj kërkesë duke e adresuar të njëjtën në KEDS
Mirëmbajtja e parkut te ambullanta dhe te pishat	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Do të shqyrtohet realizimi i kësaj kërkesë gjatë vitit aktual duke u bazuar në mundësitë buxhetore
Rregullimi i transportit publik për nxënësit e Shkollës Filllore dhe të Mesme	Këshilli i fshatit Gorancë	Adresuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale megjithatë për shkak të buxhetit tejet të limituar Komuna nuk mundet të trajtojë këtë çështje përgjatë vitit aktual.

PYETJE/KËRKESË PËR INFORMACION/SUGJERIME

Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
--	------------------------------------	---------------------------	---

6. KONKLUZIONET

Procesi i dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029 ka dëshmuar rëndësinë e pjesëmarrjes së gjerë të qytetarëve/eve dhe grupeve të interesit në përcaktimin e prioritetëve të komunës. Pjesëmarrja aktive ka mundësuar që nevojat, shqetësimet dhe propozimet e banorëve/eve të reflektohen në dokumentin buxhetor, duke garantuar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Nga dëgjimet u konstatua se prioritetet kryesore të komunitetit mbeten përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe kanalizimeve, furnizimi me ujë të pijes, ndriçimi publik, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore, si dhe mbështetja e sektorit të bujqësisë. Shumë nga këto kërkesa janë përfshirë në buxhetin e vitit 2026, ndërsa të tjera janë planifikuar për t'u realizuar në periudhën 2027–2029 ose do të adresohen te institucionet përkatëse.

Në të njëjtën kohë, u evidentua se kufizimet buxhetore mbeten sfidë kryesore për komunën, duke pamundësuar përfshirjen e të gjitha kërkesave. Megjithatë, përmes prioritizimit dhe bashkëpunimit me Ministritë e linjës, Donatorët dhe Partnerët e tjerë, komuna do të vazhdojë të kërkojë mënyra shtesë financimi për të realizuar sa më shumë projekte të propozuara.

Hapat e ardhshëm do të përfshijnë:

- Zbatimin e projekteve kapitale të planifikuara në KAB 2027-2029 sipas listës së miratuar në Kuvendin Komunal,
- Monitorimin dhe raportimin e rregullt të realizimit të projekteve për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie,
- Vazhdimin e bashkëpunimit me komunitetin për të siguruar që kërkesat e qytetarëve/eve të jenë gjithmonë në qendër të vendimmarrjes,
- Përcaktimin e një plani afatmesëm për realizimin e kërkesave të mbetura, të cilat për arsye buxhetore nuk kanë mundur të përfshihen në këtë cikël,
- Intensifikimin e përpjekjeve për të siguruar mbështetje financiare nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në përfundim, ky proces ka treguar se dëgjimet buxhetore janë mekanizëm i domosdoshëm për forcimin e demokracisë lokale, rritjen e transparencës dhe ndërtimin e një buxheti që i përgjigjet realisht nevojave të qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

